

V E N D I M

Nr. 20, datë 21.1.1999

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROJEKTIT “PËR REHABILITIMIN E GRUPIT SEKTORIAL TË UJËSJELLËSIT TË TIRANËS DHE ASISTENCËN TEKNIKE TË MENAXHIMIT TË NDËRMARRJES SË UJËSJELLËSIT”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin, në parim, të projektit “Për rehabilitimin e grupit sektorial të ujësjellësit të Tiranës dhe asistencën teknike në menaxhimin e ndërmarrjes së ujësjellësit”.
 2. Ngarkohet Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë të kërkojë financim për këtë projekt pranë qeverisë italiane, për shumën prej 60 (gjashtëdhjetë) miliardë lirash.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të negociojnë me palën italiane marrëveshjen, për financimin e projektit, në emër të qeverisë së Republikës së Shqipërisë.
 4. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të parashikojë në buxhetin e saj, si kosto lokale për të mbuluar kontributin e qeverisë shqiptare në projekt, shumën totale deri në 1.2 miliardë lekë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko